



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT DIBER

Nr. 122 Prot

Peshkopi më 17, 04, 2020

V E N D I M

Nr.03, date 16.04.2020

“Per miratimin e tavanëve përgatitore programit buxhetor afatmesem 2021-2023”

Keshilli i Qarkut Diber pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur , nga Grupi i menaxhimit Strategjik, per hartimin e tavanëve përfundimtare te projekt-buxhetit afatmesem 2021-2023, te Keshillit te Qarkut Diber, mbështetur ne: Ligjin nr.139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 41, pika 1, neni 83, pika ç, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, neni 37, pika 1, Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne Republiken e Shqiperise”, ndryshuar, Udhezimit te ministrise Financave nr 10, date 28.02.2020 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2021-2023”, Keshilli i Qarkut Diber ne mbledhjen e dt.16.04.2020, pasi mori ne shqyrtim Vendimin Nr.3 date 15.04.2020, te Kryesise se Keshillit te Qarkut” Per miratimin e tavanëve përfundimtare te programit buxhetor afatmesem 2021-2023”

V E N D O S I:

1. Miratimin e tavanëve përfundimtare te programit buxhetor afatmesem 2021-2023 sipas tabelave bashkëngjitur projektit.
2. Vendimi te dërgohet prane Institucionit te Prefektit per verifikimin e ligjshmerise.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Grupi I Menaxhimit Strategjik dhe Sektori I Finances dhe Sherbimeve ne Keshillin e Qarkut.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.
5. U shpall sot me dt.16.04.2020.

KRYETAR
Valentina Haliti

